

UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

**DREJTIMI- MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA
NË ARSIMIN FILLOR**



TEMA MASTER

Zhvillimi i performancës së nxënësve të shkallës I përmes portofolios profesionale

Mentori:

Kandidatja:

Prof.Dr. Mensur Neziri

Arbëresha Bajrami

Gjiçan, 2024

**UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I EDUKIMIT**



**DREJTIMI- MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA
NË ARSIMIN FILLOR**

TEMA MASTER

Zhvillimi i përfomancës së nxënësve të shkallës I përmes portofolios profesionale

Mentori:

Kandidatja:

Prof.Dr. Mensur Neziri

Arbëresha Bajrami

Gjilan, 2024

© [2024] - [Arbëresha Bajrami] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

FALENDERIMET

Përgatitja e kësaj teme kërkon përkushtim dhe përkrahje të vazhdueshme, e cila mund të realizohet vetëm me ndihmën e njerëzve më të dashur, që shfrytëzojnë kohën t'i falenderoj të gjithë ata që kontribuan në realizimin e saj dhe poashtu në këtë rrugëtim të studimit.

Një falenderim i veçantë shkon për stafin e Fakultetit të Edukimit e posaçërisht profesorët që kontribuan në zhvillimin dhe në ngritjen time akademike e poashtu edhe kolegët dhe koleget që shprehën përkrahje, njohuri dhe sugjerime mjaft të nevojshme.

Krejt në fund dhe jo më pak i rëndësishëm falenderim i takon familjes time për dashurinë dhe mbështjetjen tuaj duke më dhënë kurajo, durim dhe udhëzimet për më të mirat. Shpresoj të ndiheni krenar!

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI

ABSTRACT

I.HYRJE

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

II.1 Vlerësimi

[II.1.2 Tiparet e vlerësimit](#)

[II.1.3 Pse është i rëndësishëm vlerësimi i nxënësve?](#)

[II.1.4 Llojet e vlerësimeve](#)

[II.1.5 Vlerësimi i brendshëm](#)

[II.1.6 Vlerësimi i jashtëm i nxënësve](#)

II.2 Përkufizimi për portfolio

[II.2.1 Rëndësia e përdorimit të portfolios në ciklin fillor](#)

[II.2.2 Qëllimi i portfolios](#)

[II.2.3 Elementet që duhet të përmbaj portofolio](#)

[II.2.4 Autenticiteti i portfoliit](#)

[II. 2.5 Llojet e portfolios](#)

[II.2.6 Përdorimi i portfolios në vlerësim](#)

II.3 Zhvillimi i përformancës së nxënësve përmes vlerësimit formues

[II.3.1 Ndikimi i portfolios profesionale në përformancë të nxënësve](#)

[II.3.2 Përparësitë apo avantazhet e përdorimit të portfoliove profesionale](#)

[II.3.3 Mangësitë apo disavantazhet e përdorimit të portfoliove profesionale](#)

II.4 Nocionet themelore të studimit

[II.4.1 Nocioni vlerësim](#)

[II.4.2 Nocioni portfolio profesionale](#)

[II.4.3 Nocioni vlerësimi përmes portfolios](#)

[II.4.4 Nocioni nxënës](#)

II.4.5 Nocioni mësues

III.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

III.1 Metoda e hulumtimit

III.2 Objektivat e hulumtimit

III.3 Pyetjet e hulumtimit

III.4 Hipotezat

III.5 Parashtrimi i problemit

III.6 Rëndësia e hulumtimit

III.8 Populacioni dhe mostra

III.9 Instrumentet matëse

III.10 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

III.11 Etika e hulumtimit

IV REZULTATET E HULUMTIMIT

IV.1 Intervista e realizuar me mësueset

IV.2 Përmbledhje e intervistës së realizuar me mësime dhënëse

IV.3 Lista e kontrollit për shqyrtimin e portofolive

V. DISKUTIMET

V.1 Argumentimit i gjetjeve të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të hulumtimit

VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

VI.1 Përfundimet

VI.2 Rekomandimet

LITERATURA

SHTOJCAT

Shtojca 1. Listë kontrolli për shqyrtimin e portofolive

Shtojca 2. Pyetjet për intervistën me mësueset

Lista e tabelave

Tabela 1. Paraqet përparësitë e vlerësimit përmes portfolio krahasuar me testet e standardizuar.....	35
Tabela 2. Të dhënat e pjesmarrësve të intervistës.....	45
Tabela 3. Portofolio për nxënësit e klasës parafillore.....	49
Tabela 4. Portofolio e klasës së parë.....	49

Tabela 5. Portofolio e klasës së dytë.....	50
Tabela 6. Çfarë përmban dhe çfarë nuk përmban portofolio i nxënësve nga shqyrtimi i bërë.	50
Lista e grafikëve	
Grafiku 1. Vlerat e portofolios.....	27

ABSTRAKTI

Procesi i vlerësimit është shumë i rëndësishëm, i cili ndikon në ngritjen e cilësisë dhe të përparimit të nxënësve, prandaj të zgjedhen mënyra të ndryshme vlerësimi poashtu ka një rëndësi, pasi që ndikon në performancën, ngritjen e cilësisë dhe të përparimit të nxënësve.

Procesi i vlerësimit të nxënësve përmes portofolios është i përcaktuar në Kurrikulën e Kosovës, prandaj mund të konsiderojmë që ndikon në performancë të nxënësve.

Përmes këtij hulumtimi synoj që të shoh përdorimin e portofolios në vlerësimin e nxënësve, përkatësisht zhvillimin e performancës së nxënësve nga përdorimi i portofoliove në ciklin fillor të shkollës së parë. Metodologjia e hulumtimit do të jetë cilësore, që përmes instrumenteve siguron pamje të qarta të ndikimit të portofoliove në performancë të nxënësve.

Një nga instrumentet vlerësuese, që është përzgjedh si objekt për të studiuar ka rëndësi pasi që bëhet njohja më e mirë e nxënësit dhe performancës së tij, të shohim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, kohë pas kohe përmes saj vëzhgohet se si po lëviz trajektorja e zhvillimit të tij.

Me këtë mund t'i shohim pikat e forta dhe të dobta të nxënësve, por nuk përfshihen ende si një plan në procesin e vlerësimit, poashtu edhe përdorimin e portofoliove në të gjitha fushat kurrikulare pasi që është proces i vazhdueshëm dhe që e mban të angazhuar nxënësin.

Mësimdhënësi, duke pasur parasysh të gjitha llojet e vlerësimit, të siguroj përdorimin e të gjithave, pasi që sipas saj mund të arrij të vlerësoj arritjet dhe zhvillimin dhe të evidentoj çdo nevojë për mbështetje dhe motivim.

Fjalët kyce: cikli fillor, performancë, portofolio, vlerësim.

ABSTRACT

The evaluation process is very important, which affects the quality and progress of students, therefore choosing different methods of evaluation is also important, as it affects the performance, quality and progress of students.

The process of evaluating students through the portfolio is defined in the Kosovo Curriculum, therefore we can consider that it affects the performance of students.

Through this research, I aim to see the use of portfolios in student evaluation, namely the development of student performance from the use of portfolios in the primary cycle of the first grade. The research methodology will be qualitative, which through instruments provides clear views of the impact of portfolios on student performance.

One of the evaluation instruments, which has been selected as an object to study, is important because it gives a better understanding of the student and his performance, to see the progress and progress of the student, from time to time through it is observed how the trajectory of development is moving his.

With this we can see the strengths and weaknesses of the students, but they are not yet included as a plan in the assessment process, as well as the use of portfolios in all curricular areas as it is a continuous process and keeps them engaged the student.

The teacher, considering all types of assessment, ensure the use of all of them, since according to her I can assess achievements and development and identify any need for support and motivation.

Key words: primary cycle, performance, portfolio, evaluation.

I.HYRJJE

Vlerësimi i nxënësve në grupmoshat e ciklit fillor është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës, është shumë e rëndësishme të shohim praktika më të mira, llojet të ndryshme që mund të ndikojnë në performancën e nxënësve.

Lloji i vlerësimit, ta përzgjedhim në bazë të grupmoshave përkatëse, të bazohet në rezultatet e të nxënësve, të gjykohen arritjet e nxënësve, të gjithë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qendrimet, të gjitha përkundrejt nivelit të arritjes së rezultateve të të nxënësve. Poashtu është e rëndësishme, si gjatë procesit të të nxënësve, pjesëmarrja aktive, poashtu edhe gjatë procesit të vlerësimit të krijohet pjesëmarrje aktive, të mundësohet nxënësve të punoj dosjen e vet personale dhe kështu në mënyrë direkte të jetë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit. Kjo më pas mund të ndikoj edhe në zhvillim të performancës dhe të nxënësve.

Për të parë zhvillimin e performancës së nxënësve përmes portofolios, si manifestohen llojet e ndryshme në shkallën e I të ciklit fillor dhe poashtu cili është rezultati që ato na japin, cili është roli i mësuesit në aplikimin dhe dhënien e një rezultati të kënaqshëm të kësaj praktike mësimore, kam zgjedhur të bëj në klasët e shkallës së parë të kurrikulës, i cili hulumtim do të më shërbejë edhe në përvojat e mia si një mësimdhënëse. Kjo më ka shtyrë që nga afër të shoh zhvillimin e performancës së nxënësve përmes punimit të një portofolio, ky lloj vlerësimi ndikon pozitivisht apo negativisht në zhvillimin e tyre si dhe një mundësi shumë e mirë për të vlerësuar nxënësve në mënyrë të vazhdueshme.

Së bashku me nxënësve, në këtë proces janë të përfshirë edhe mësimdhënësit. Nxënësve, me përfshirje të tyre dhe interesimin në punimin e një portofolio dhe llojin e portofoliove që ata punojnë, mund të luajnë rol të rëndësishëm që nxënësve të ketë dëshirë të punojë ato në mënyrë aktive dhe të përfitojë nga ato.

Nëpërmjet portofolit mësuesi i drejton nxënësve në koleksionimin e rezultateve të të nxënësve sipas një rendi të mirëstrukturuar me qëllim vlerësimin, vetëvlerësimin dhe shkëmbimin e këtyre arritjeve.

Gjithashtu mësuesit, nëse kanë informacione dhe janë të trajnuar në lidhje me atë se si punohet portofolio, mund të jenë një faktor shumë i rëndësishëm në përfundimin e suksesshëm të tyre nga nxënësve dhe arritjen e efekteve pozitive si dhe ndikimin në motivimin në të nxënësve të nxënësve. Duke ditur që portofolio është pjesë aktive dhe e pandalshme në procesin e mësimdhënies, pasi që e dokumenton mësimdhënien dhe të nxënësve, garanton në cilësinë e zhvillimit të kurrikulës, poashtu mund të krijoj edhe qëndrueshmëri në të gjithë sistemin arsimor, prandaj për mua ka qenë e rrugës dhe shumë e rëndësishme, e nxitur apo edhe kurioze për të hulumtuar më gjerë rreth kësaj teme që na jep shumë mundësi të mira për të zhvilluar nxënësve në mënyrë të vazhdueshme.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Shqyrtimi i literaturës rreth vlerësimit, zhvillimit të performancës së fëmijëve përmes përdorimit të portofolios profesionale, i cili është mbështetur në numër të madh teorish nga autorë të ndryshëm në vite të ndryshme të studimeve është trajtuar në këtë pjesë. Ketu trajtohet nevoja për vlerësimin e fëmijëve përmes portofolios në mënyrë që fëmijët të shohin përparimin e tyre si dhe të jenë përgjegjës për arritjet e tyre.

II.1 Vlerësimi

Sipas Bron, Bull, & Pendlebury (1997) „termi **“vlerësim”** vjen nga latinishtja **“ad sedere”**, që do të thotë **të ulesh pranë**. Si rrjedhojë, vazhdohet më tej, vlerësimi **“është kryesisht i fokusuar në ofrimin e udhëzimeve dhe feedbackut (informacionit kthyes) të fëmijëve”**.

Gjatë vlerësimit kontrollohet përparimi i të arriturave të nxënësve në bazë të asaj sesi orientohen nxënësit drejt qëllimeve të parashtruara në mësim (MASHT, 2010).

Sipas MASHT (2018) parimet mbi të cilat mbështet vlerësimi në fëmijërinë e hershme janë:

- **Vlefshmëria:** Vlerësimi duhet të sigurojë se kërkesat e tij janë të lidhura me pritjet për secilin fëmijë dhe grup edukativ, se përdoren matje dhe burime të shumta, dhe se vlerësimi përfshin të gjithë përmbajtjen e kurrikulës parashkollore.
- **Transparenca:** Vlerësimi duhet të sigurojë se metodat dhe procedurat e vlerësimit janë të njohura për prindërit (kujdestarët primarë) dhe për të gjithë akterët e përfshirë në

procesin e vlerësimit. Informacioni për prindërit lidhur me rezultatet e arritura, informatat kthyesë dhe mundësitë e përparimit të jetë i qartë, i saktë dhe të jepet me kohë.

- **Besueshmëria:** Vlerësimi duhet të sigurojë se bazohet në instrumente, lloje të ndryshme të vlerësimit dhe burime të ndryshme të informacionit. Në këtë proces ofrohen dëshmi për të argumentuar cilësinë dhe besueshmërinë e vlerësimit.
- **Paanshmëria:** Vlerësimi duhet të sigurojë se respektohen kërkesat e kodit etik të vlerësimit, nuk bëhen anime në vlerësim duke u ndikuar nga karakteristikat dhe rrethanat e veçanta të fëmijës, respektohen procedurat e vlerësimit ndaj çdo fëmije apo grupi të fëmijëve, përdoren instrumente të ndryshme të vlerësimit që i mundësojnë secilit fëmijë të shfaqë performancën e tij/saj dhe ofrohet mbështetja e duhur në zhvillimin dhe të nxëniet e fëmijëve drejt arritjes së standardeve të zhvillimit dhe të pritave për fëmijët sipas grup-moshës.

Sipas Musai (2014), vlerësimi u shërben disa qëllimeve të ndryshme. Më të shpeshtat janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve. Ky informacion e aftëson mësuesin të konsiderojë sa e suksesshme ka qenë mësimdhënia e tij për të arritur rezultatet e caktuara mësimore. Në mënyrë të veçantë, ai mund të hedhë dritë mbi probleme të veçanta ose keqkuptime, të cilat kërkojnë veprim riparues në vazhdimësi të mësimdhënies.
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor. Vlerësimi i aftëson nxënësit të krahasojnë arritjet e tyre me standardin e pritshëm po prej tyre, që të përdorin informacion të detajuar për t'u korrigjuar dhe të vlerësojnë më qartë kërkesat e detyrave të caktuara.
3. T'i motivojë nxënësit. Veprimtaritë vlerësuese i nxisin nxënësit të organizojnë mirë punën e tyre dhe të mësojnë çfarë u kërkohet që të dalin me sukses. Nxitja mund të bazohet në motivimin e brendshëm, të jashtëm ose në të dyja bashkë. Suksesi në një detyrë të vështirë është mjaft efikas në nxitjen e motiveve të ardhshme.
4. Të shënojë përparimin e nxënësve. Vlerësimi i rregullt aftëson mësuesin të shënojë përparimin e nxënësve për një periudhë të gjatë kohe. Kjo përbën bazën e vendimeve rreth gjendjes aktuale të çdo të nxënësi, si dhe të nevojave në të ardhmen. Ai mund të përdoret, gjithashtu, për komunikimin me të tretët (prindërit, organet e ndryshme administrative etj.) dhe mund të ndikojë në punën e mësuesit në të ardhmen.
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktuale. Vlerësimet mund të përdoren për të identifikuar standardin e realizimit të objektivave në kohë të ndryshme. Një arritje e tillë mund të formojë bazat e vlerësimit të pjesshëm ose përfundimtar, të pasqyruar në dëftesën shkollore ose në një dokument tjetër.

6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen. Vlerësimi mund të përdoret për të treguar nëse nxënësit janë të gatshëm për një tip të veçantë të nxënies (të mësojnë, të lexojnë, të kryejnë veprime të ndryshme matematike etj.), për të përcaktuar më mirë mënyrën e punës në grupe, për të identifikuar nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të verifikuar nëse nxënësit i kanë përvetësuar mësimet e mëparshme dhe, nëse jo, të bëjnë përsëritje ose parapërgatitje.

Zgjedhja e një vlerësimi adekuat në një lëndë, fushë apo situatë të caktuar është mjaft sfiduese për mësuesin, sepse ai do të përballet me një varg të papriturash gjatë gjyqimit të tij. Vendimet e mësuesit, si dhe ajo çka do të vlerësojë, varen nga qëllimet që ka mësuesi në mendje për mënyrën e vlerësimit. Pjesë e vështirësive që hasin mësuesit në një përdorim sa më të suksesshëm të vlerësimit është nevoja për të harmonizuar qëllime dhe lloje të ndryshme të vlerësimit. Po ashtu ata duhet të sigurohen që kanë mënjanuar apo kanë kufizuar në mënyrë të plotë ndonjë efekt të padëshirueshëm. (Ahmedi, 2019)

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

vlerësimit të vazhduar (vlerësimi për të nxënë) (40%);

vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënësve) (40%);

vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësve (20%). (Andoni, 2016)

Sipas Kornizës së Vlerësimit në ciklin fillor në Shqipëri (2019) vlerësimi, për qëllim ka mbështetjen dhe ndihmën e nxënësve. Që ky vlerësim të arrijë këtë funksion atëherë ai duhet të jetë:

- Periodik;
- I dokumentuar;
- I qëllimshëm për rezultate të caktuara të të nxënësve;
- Identifikues i pikave të forta, të dobëta gjatë të nxënësve;
- Të jetë stimulues, për rritje të vetërespektit dhe të kuptimit për veten;
- Të kryhet nëpërmjet simbolikave të përshtatshme për moshën e fëmijëve (p. 5).

Sipas Kornizës së Vlerësimit në ciklin fillor në Shqipëri (2019) vlerësimi bëhet i vlefshëm kur është periodik, i dokumentuar, konfidencial dhe ndahet me prindërit” (p. 5).

Përveç standardeve të vlerësimit të cilët trajtojnë edhe moshën parashkollore dhe Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar), në Kosovë nuk ka një kornizë të veçantë e cila rregullon çështjen e vlerësimit sikurse në Shqipëri.

II.1.2 Tiparet e vlerësimit

Sipas studimit të bërë nga Shehu, et. al. (2014) si tipar të vlerësimit i ka cilësuar:

Tipari kryesor i vlerësimit është autenticiteti.

Secili fëmijë është i veçantë dhe secili paraqet “rrëfim në vete” dhe pikërisht për këtë fakt autenticiteti është një ndër tiparet kryesore të vlerësimit. Jo secili fëmijë do ta arrijë secilin standard dhe jo të gjithë fëmijët do t’i arrijnë standardet me tempo të njëjtë.

Që të jetë vlerësimi i saktë dhe i drejtë ai duhet të jetë objektiv.

Në qoftë se vlerësimi që ne e bëjmë bazohet në ndjenja apo intuitën tonë, atëherë ky nuk është vlerësim i drejtë dhe i saktë edhe njëherazi nuk është objektiv.

Fëmijët nuk mund të shprehin gjithmonë njëjtë shkathtësitë e tyre, disa ditë është më i disponuar e disa ditë më pak, andaj nëse ne e vlerësojmë fëmijën pa e vëzhguar një kohë nuk mund të nxjerrim një përfundim të duhur. Njëherazi, jo të gjithë edukatorët do ta interpretojnë njësoj një aktivitet të njëjtë, sepse edhe interpretimi i aktiviteteve të fëmijës nga vetë edukatori deri diku i nënshtrohet subjektivitetit.

Mësuesi duhen të fokusohen në atë se çfarë “mund” dhe “di” fëmija.

Në qoftë se ne si mesues bazohemi në atë se çfarë nuk di nxënësi atëherë kemi bërë një vlerësim kritik. Nuk mund t’ia japim nxënësve një detyrë që ta përfundojë dhe ne të vlerësojmë se a mund ose a di nxënësi ta përfundojë detyrën e caktuar, duhet që ta marrim për bazë se ndonjëherë nxënësi nuk është në disponim ta përfundojë detyrën dhe në fund nuk jemi për të vlerësuar atë që nuk di ose nuk mund ta bëjë nxënësi. (Shehu, et al., 2014).

Sipas IZHA (2016) “Vlerësimi tërësor bëhet në respekt dhe në përmbushje të fushave të të nxënit, të rezultateve të pritshme, duke iu referuar fëmijës si individualitet i papërsëritshëm.

Thelluar në përmbajtje, është më e saktë të themi se ne vlerësojmë sjelljet, aftësitë, kompetencat, shkathtësitë, qëndrimet, preferencat dhe ndërveprimet e fëmijëve të vegjël se sa të themi se po vlerësojmë nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve bëhet për të mbledhur informacion rreth zhvillimit dhe të nxënit të nxënësve, nga mjedisi mundësues dhe nga e gjithë veprimtaria edukative që organizohet nga mësuesit dhe prindërit, me qëllim mbështetjen dhe ndihmën për nxënësin në procesin e zhvillimit dhe të nxënit të tij.

Veprimtaritë dhe aktivitetet e përditshme si përfshirja dhe angazhimi në lojë dhe aktivitete individuale apo në grupe (me fëmijë dhe të rritur), vizatimi, këndimi, vallëzimi, ndërtimi i blloqeve, bisedat me fëmijë dhe të rritur, ushtrimet fizike, ushqimi, pushimi, etj., janë bazë e vlerësimit të nxënësve (MASHT, 2020).

Vlerësimi bëhet për të mbledhur informacion rreth zhvillimit, të nxënit dhe përfitimit të nxënësve nga kurrikula, metodat e mësimdhënies, mjedisi dhe e gjithë veprimtaria mësimore-edukative. Vlerësimi kryhet gjatë veprimtarive të përditshme në grup: kur fëmijët janë duke biseduar me

fëmijët e tjerë ose me të rriturit, kur janë të përfshirë në lojëra dhe veprimtari individuale apo me të tjerë, kur janë duke bërë punime artistike ose duke ndërtuar me blloqe, kur janë duke ndenjtur vetë dhe duke u marrë me sendet personale, kur janë duke u marrë me veprimtari fizike, duke ngrënë ose duke pushuar (IZHA, 2016).

II.1.3 Pse është i rëndësishëm vlerësimi i nxënësve?

MASHT (2018) theksoi se vlerësimi si proces jep informata mbi progresin e fëmijës, duke siguruar përkrahjen dhe forcimin e të nxënësve dhe raportimin e rregullt të përparimit individual të secilit nxënës.

Vlerësimi u jep mësuesit të dhëna thelbësore për:

- Mënyrën se si mësojnë nxënësit dhe
- Çfarë njohurish dhe aftësish ka përfituar çdo nxënës; ku ai/ajo është duke ecur mjaft mirë, dhe ku ai/ajo mund të jetë duke pasur vështirësi
- Të planifikuar punën me fëmijët në mënyrë më të saktë (p. 76)

Vlerësimi ofron gjithashtu informacion të rëndësishëm për familjet për:

- Mënyrën se si po përparojnë fëmijët e tyre
- Fushat ku janë të interesuar fëmijët e tyre
- Fushën ku ata kanë nevojë shtesë dhe se si familjet mund të ofrojnë mbështetje kur fëmijët janë në shtëpi (p. 76)

Vlerësimet mund të kryhen gjatë aktiviteteve të përditshme kur fëmijët janë:

- Duke biseduar me fëmijët e tjerë
- Duke biseduar me të rriturit
- Të angazhuar në aktivitetet me lojëra (p.sh. të vetëm, në bashkëpunim)
- Duke krijuar punime artistike ose duke ndërtuar me materiale të ndryshme
- Duke u marrë me libra, revista, albume, etj.
- Duke u marrë me aktivitetet fizike — qoftë motorike të mëdha ose të vogla
- Duke përdorur teknologji
- Duke manipuluar me materiale që vënë në përdorim shqisat
- Duke ngrënë apo duke pushuar (pp. 77-78)

Përse duhet të vlerësojmë?

Fëmijët kanë ndryshime në përmbushjen e treguesve të fushave të ndryshme të zhvillimit dhe ky ndryshim konsiderohet si një pjesë e natyrshme e aspekteve të zhvillimit njerëzor. Përvojat gjatë fëmijërisë së hershme i kanë ndihmuar fëmijët ta nxisin trurin të mësojë dhe të reagojë në mënyra të caktuara, të zhvillojnë disa fusha më shumë sesa të tjerat dhe të njohin disa fusha zhvillimore që

nuk janë formësuar ende mirë. Është me rëndësi që mësuesit të kuptojnë çfarë e bën secilin fëmijë të veçantë dhe ta ndihmojë të ndjekë shtegun e vet të të nxënit (IZHA, 2016).

II.1.4 Llojet e vlerësimeve

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar) (2016) përcakton dy lloje të vlerësimit:

- Vlerësimi i brendshëm
- Vlerësimi i jashtëm

II.1.5 Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel shkolle/klase nga mësuesit e shkollës dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Vlerësimi i brendshëm bëhet për disa qëllime, si për përparimin dhe arritjen në të nxënë, për planifikim të punës me nxënë, për identifikimin e prirjeve dhe talenteve të nxënësve, etj. Vlerësimi i brendshëm duhet t'iu mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin njohuritë e reja dhe të tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave duke përfshirë:

- Gjerësinë dhe thellësinë e tyre
- Gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit të përcaktuar me rezultatet e të nxënit
- Aftësinë për t'i zbatuar ato në situata dhe rrethana të reja (p. 48)

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm duhet të jetë mbështetja e të nxënit të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit formativ (për nxënie) dhe vlerësimit përmbledhës (i të nxënit).

Llojet e vlerësimit të brendshëm

Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë (p. 48)

Korniza përcakton periudhën e realizimit të secilit lloj të vlerësimit, bartësit/përgjegjësit e vlerësimit, qëllimet kryesore dhe mënyrat e dokumentimit/evidentimit të arritjeve të nxënësve.

Sipas MASHT (2016) *Neni 3*.

Vlerësimi i brendshëm i nxënësit

3.3. Vlerësimi përmbledhës është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënit. Realizohet nga mësimdhënësi gjatë gjithë vitit shkollor bazuar në rezultatet e të nxënit për klasë dhe bëhet me notë.

3.7. Nxënësit e nivelit I (klasa përgatitore dhe klasat 1 – 5) vlerësohen vetëm me Vlerësim Përmbledhës.

3.7.2. Nxënësit e shkallës I (klasa përgatitore dhe klasat 1 – 2) nuk vlerësohen me notë numerike por vlerësohen me komente konstruktive të standardizuara kundrejt rezultateve të të nxënit.

II.1.6 Vlerësimi i jashtëm i nxënësve

Vlerësimi i jashtëm është vlerësim i standardizuar për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit, zotërimin e kompetencave në fund të nivelit I, II dhe III të arsimit parauniversitar. Ky vlerësim organizohet nga autoriteti qendror për vlerësim i autorizuar nga MASHT. Me kërkesë të MASHT-it vlerësimi i jashtëm mund të bëhet edhe për qëllime të tjera nga institucione tjera relevante.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- Inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle dhe komune.
- Hulumtimi dhe zhvillimi
- Vendimmarrjeje e politikëbërje në fusha të ndryshme të arsimit (p. 50)

Ekzistojnë një sërë mjetesh/instrumentesh vlerësimi që mund t'i përdorin mësuesit për të zbatuar analizat zhvillimore si dhe vlerësimet formative, vlerësimet e përkohshme dhe vlerësimet përmbledhëse (2018).

Dokumentimi pedagogjik

Dokumentimi shërben për të krijuar një të dhënë vizuale të procesit të të nxënit të nxënësve. Mësimdhënësi duke marrë për bazë aktivitetet që iniciohen nga nxënësit, ofrojnë një kornizë për të filluar një bisedë dhe drejtojnë të nxënit e nxënësve. Dokumentimi është një proces i përbashkët si për mësuesen ashtu edhe për nxënësin që të angazhohen në aktivitete bashkëpunuese për të planifikuar temat e ardhshme të aktiviteteve mësimore.

Shënimet e shkurtra

Shënimet e shkurtra [anekdotike] janë përshkrime të shkurtra, faktike, narrative të sjelljeve të fëmijëve dhe aftësive të tyre. Këto shënime, duhet të jenë sa më objektive dhe vetëm në formën e disa fjalive të shkurtra.

Listat e kontrollit dhe vëzhgimi

Një listë kontrolli është një mekanizëm që mësuesit mund ta përdorin për të ndjekur të nxënit e fëmijëve në kohë. Listat e kontrollit mund të strukturohen në një mënyrë të tillë që të ofrojnë të

dhëna për vlerësimin formativ ose mund të strukturohen për të dhënë të dhëna për vlerësimet e përkohshme.

Krijimi i portfolios

Një portfolio është një mjet i rëndësishëm për të komunikuar jo vetëm për të mësuarit e një nxënësi, por gjithashtu për të ofruar dëshmi për të mbështetur konkluzionet e mësuesve në lidhje me pikat e forta, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve. Mësuesit mund të krijojnë dosje për çdo nxënës në ciklin fillor. Portfolio përmban shembuj të punës së nxënësve në angazhimin e tyre në aktivitete në fusha të ndryshme përgjatë vitit. Këta shembuj duhet të përfaqësojnë punën tipike të nxënësve (jo vetëm më të mirën ose më të keqen). Po ashtu portfoliot përmbajnë edhe shënime të shkurtra, domethënëse, faktike nga mësuese, të dala nga vëzhgimi i nxënësve.

Megjithatë, është e rekomandueshme që portfoliot të krijohen së paku dy herë në vit në mënyrë që të krahasohen për progres.

II.2 Përkufizimi për portfolio

Edhe pse portfolet përdoren në vlerësimin e performancës së studentëve në ditët e sotme ato përdoren si metodë nga arkitektë, piktorë, fotografë dhe artistë në duke treguar punimet e tyre. Megjithatë, pasi portfoli është përdorur për qëllime të ndryshme ndoshta ndryshe nga ajo e artistëve. Nuk është e mundur të përdoret vetëm një përkufizim për portfolin.

Përkufizimi i portfolit mund të ndryshojë sipas qëllimit të përdoruesve dhe mënyrës së përdorimit. Shumëstudiuësit përcaktuan portfolin për të shpjeguar veçoritë e tij.

Sipas studimit të bërë nga O. Biring, A. Baki (2007) kanë konstatuar se nuk mund të përdorim vetëm një përkufizim për portfolin. Përkufizimi i portfolit mund të ndryshojë në bazë të qëllimit të përdoruesit dhe mënyrës së përdorimit.

Portfoli është vetëm një mënyrë e mbledhjes së të dhënave dhe dokumentimit të zhvillimit dhe mësimi i fëmijës. *Termi 'portofol' vjen nga fjala frënge që do të thotë çantë portfeuille, letrave me vlerë* (Warash & Workman, 2016).

Sipas Grace (1993) “Portfolio është një procesverbal i procesit të të mësuarit të nxënësit çfarë nxënësi ka mësuar dhe si ai/ajo mendon, pyet, analizon, sintetizon, prodhon, krijon dhe si ai/ajo bashkëvepron intelektualisht, emocionalisht dhe shoqërisht me të tjerët”.

Studimi i bërë nga Warash & Workman (2016) shpjegon se “Portfolio është një koleksion artikujsh, i zgjedhur në atë që fëmija di, se çfarë mund të bëjë, që do të mblidhen gjatë një periudhe kohore dhe të cilat janë dëshmi e përpjekjeve të fëmijës, sukseset dhe përparimi”. Portfoli si një metodë e monitorimit dhe dokumentimit të zhvillimit të fëmijëve është përdorur gjithnjë e më shumë në praktikën edukative. Kjo është një mënyrë pozitive e vlerësimit, vlerësimi i punës së

fëmijëve, jo vetëm që siguron mundësinë për të ndjekur zhvillimin e një fëmije, por gjithashtu lejon që përparimi të vlerësohet nga të tjerët.

Portofoli i nxënësit është tërësia e detyrave, e projekteve, e punëve, e vlerësimeve që nxënësi përgatit dhe përmbush për të realizuar kompetencat e parashikuara në kurikul.

Portofoli i mësuesit është një pasqyrim i mësimdhënies bazuar në dëshmi.

Mësimdhënia (dhe të nxënët), vështruar përmes portofolit, ndihmon të eksplorojmë dhe të zhvillojmë qasjet për një mësim të efektshëm.

Përmes portofolit pasqyrohen dhe dokumentohen qasjet e mësimit bazuar në kompetenca/ performancën e nxënësit.

Në thelbin e tij portofoli, me dokumentacionin që e përbën, argumenton përgjegjësitë e mësuesit në lidhje me mësimdhënien dhe përgjegjësitë e nxënësit për të nxënë. (Andoni, 2016)

II.2.1 Rëndësia e përdorimit të portfolios në ciklin fillor

Nxënësit duhet të kuptojnë se portfolio është një vend ku ruhen punime, të cilat tregojnë çfarë kanë nxënë gjatë vitit. Në këtë mënyrë, nxënësit kanë mundësi të kontribuojnë me punime që mendojnë se përfaqësojnë rritjen e tyre të të nxënësit si dhe interesat që kanë. Mësuesi bashkë me Nxënësin duhet të shikojnë punimet dhe të bëjnë krahasimet.

Krahasimi duhet të përqendrohet gjithnjë te rritja dhe nxënia e nxënësit dhe jo të krahasohet me nxënësit e tjerë. Gjithsesi, mësuesi mund të përdorin punimet për të krahasuar nxënësit me atë çka është tipike për moshën, në mënyrë që të planifikojnë hapat e tjerë të të nxënësit. Ky proces është gjithashtu i dobishëm për të diskutuar ecurinë e nxënësit me prindërit.

Prindërve mund t'u tregohet ecuria dhe të nxënësit apo që nxënësi po has në vështirësi dhe ka nevojë për ndihmë shtesë. Ai qartëson nivelet e aftësive që zotëron nxënësi.

Portfolio mbushet me punime të përzgjedhura, përfaqësuese të nxënësve. Përdorimi i punës origjinale do të ndihmojë vetë nxënësin, mësuesin dhe prindin të shohin ecurinë e tij në çdo kohë. Portfolio është një mënyrë për të organizuar punimet përfaqësuese me kalimin e kohës, për të treguar rritjen e nxënësve. Mësuesi mund t'i diskutojë punimet me fëmijët dhe të përshkallëzojë bisedën duke dhënë shembuj pozitivë dhe duke dhënë sugjerime për rritjen e tyre. Kjo është një mënyrë shumë e efektshme për t'ua mësuar nxënësve të vegjël vetëreflektimin, në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë për t'u përmirësuar në të ardhmen.

Referuar qasjes së re kurrikulare portofoli i të nxënësit merr një vend të posaçëm pasi:

mbështet zbatimin e kurrikulës të bazuar në kompetenca;

krijon qëndrueshmëri në procesin e realizimit të saj;

ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës dhe të arritjes së të nxënësve. (IZHA, 2016)

II.2.2 Qëllimi i portfolios

Një portofol nuk është një koleksion i punës së një studenti në mënyrë të rastësishme me kalimin e kohës. Për të zhvilluar një portofol, është e rëndësishme të vendosni për qëllimin e tij, evidenca që përbëhet nga portofoli, dhe kriteret e vlerësimit të tij. Ka një lidhje të ngushtë tre aspekte, dhe këto aspekte ndikojnë drejtpërdrejt në njëri-tjetrin. Çfarë duhet marrë parasysh gjatë organizimit të përmbajtjes së portofolit shpjegohet në detaje si më poshtë?

Aktet e para dhe më të rëndësishme të përgatitja e portofolit duhet të përcaktojë qëllimet për portofolin. Qëllimi i portfolios ndikon drejtpërdrejt në procesin me të cilin krijohet portofoli. Gjithashtu, qëllimet të portofolit përcaktojnë se çfarë lloj artikujsh duhet të jenë në të.

Portofoli mund të përdoret për qëllime të ndryshme në arsimimi. Qëllimi i portofolit mund të formësohet në varësi të kërkesave të përdoruesve. Qëllimi i mësuesit që përdor portofolin është të vlerësojë përparimin e nxënësve gjatë një periudhe prej kohë, për të përcaktuar efikasitetin e mësimdhënies, për të pasur lidhje me prindërit e nxënësve, të vlerësojnë programin arsimor, t'u mundësojnë shkollave të kenë kontakt, për të ndihmuar nxënësve për vetëvlerësim dhe për të përcaktuar të dobët e nxënësve, pikë në procesin e të mësuarit.

Si rezultat, ka qenë e nevojshme për të përcaktuar fillimisht qëllimin për portofolin kështu që do të ndikojë drejtpërdrejt në kualifikimet dhe koleksionet e fotove të artikujve në portofol.

Duke marrë parasysh qëllimin e portofolit, duhet të përcaktohet se cilat prova duhet të mblidhen, kush do të mblidh punimet, sa shpesh do të mblidhen dhe si do të vlerësohen.

Së pari, përmendet qëllimi i portofolit në mënyrë eksplicite dhe më pas, duhet të shpjegohen kriteret e vlerësimit të secilit zë në portofol. Është shumë e rëndësishme të përcaktohen kriteret për vlerësimin e portofolit. Sepse një kriteri i vlerësimit i lejon nxënësve të njohin dhe të zgjedhin punën që konsiderohet e lartë cilësisë. Ai gjithashtu lejon dhe inkurajon diskutime midis mësuesve, nxënësve dhe të tjerëve në lidhje me rezultatet dhe cilësinë e rezultateve. Kriteret e vlerësimit të cilat kanë qenë përdoret për të përcaktuar cilësinë e performancës së nxënësve duhet të jetë e qartë dhe e lehtë për t'u kuptojnë. Kjo është mjaft e rëndësishme në aspektin që nxënësi të vlerësojë punimet e veta dhe të jetë në gjendje të përmbushë dobësitë e tij. Rubrikat duhet të përdoren për të përcaktuar cilësinë e dëshmi në portofol dhe për të bërë një vlerësim të besueshëm dhe të vlefshëm.

(Baki & Birgin, 2004)

Një ndër qëllimet kryesore që posedon portofolio tek nxënësve është që të japë informacione gjithëpërfshirëse lidhur me të, i cili në theks të veçantë ka përparimin e tyre.

Është e rëndësishme që gjatë mbledhjes së punimeve të nxënësve gjithmonë të jenë të shënuar data se kur është bërë ai punim, në mënyrë që të shihet ndryshimi dhe përparimi i nxënësve gjatë një periudhe kohore.

Sipas studimit të bërë nga Warash & Workman (2016) theksuan se portfolio si një metodë e monitorimit dhe dokumentimit të zhvillimit të nxënësve, ofron një gamë të gjerë të mundësive në mënyrë që mësuesi të përcjellin një panoramë të plotë prindërve të tyre, në hapa të drejtë në rrugën e tyre të rritjes, dhe sipas tyre si një ndër qëllimet e portfolios është që kur nxënësi më vonë të fillojnë portfolin e klasës së parë, mësuesja/ mësuesi do të kenë një pamje të plotë për nxënësit që erdhën në klasën e tyre.

Grafiku 1. Vlerat e portofolios

(IZHA, 2016)

II.2.3 Elementet që duhet të përmbaj portofolio

Sipas shqyrtimit të bërë nga Grace (1993) autorë të ndryshëm kanë dhënë mendime lidhur se çfarë mund të përfshijë një portofolio. Sipas tij portfoli mund të përfshijë kampione pune, regjistrime të formave të ndryshme të vëzhgimeve sistematike, dhe teste shqyrtimi.

Gjatë vëzhgimit sistematik, nxënësi duhet të respektohen kur ata janë duke luajtur vetëm, në grupe të vogla, në grupe të mëdha, dhe në rrethana të ndryshme. Mbani të organizuar portfolin e secilit nxënësi duke i ruajtur sendet e mbledhura në portofolio, lidhës, kuti skedarësh, sirtar i caktuar, ose enë tjetër e përshtatshme.

(Grace, 1993) theksoi: Në mënyrë ideale, një portfoli përfshin vëzhgime në disa ose në të gjitha format e mëposhtme:

Regjistrime anekdotale

Janë rrëfime të shkurtra të ngjarjeve të veçanta. Ata tregojnë një pikurë me fjalë. Ato duhet të japin informacion faktik për çka ndodhi, kohën kur ndodhi, vendin ku ndodhi, nxitjen për aktivitetin, reagimet e nxënësit dhe fundin e veprimit. Ato mund të citojnë fjalët e nxënësit e të përshkruajnë cilësinë e sjelljes (Coughlin, et al., 1997).

Lista kontrolluese

Procesi i mbledhjes së të dhënave është bërë gjatë një periudhe gjashtëmujore, për të dy institucionet arsimore.

Fillimisht janë njoftuar drejtorët e shkollave të institucioneve arsimore për qëllimin e hulumtimit dhe është kërkuar leje për të zhvilluar procesin e hulumtimit, ku pas miratimit është realizuar intervista me mësimdhënësit dhe më pas është bërë shqyrtim i portfoliove të nxënësve të shkallës së parë, pra nga dy nga klasa parafillore, dy nga klasa e parë dhe dy nga klasën e dytë.

III.11 Etika e hulumtimit

Gjatë gjithë procesit të hulumtimit është marrë në konsideratë respektimi i parimeve etike dhe profesionale me një qasje serioze dhe të përgjegjshme, duke respektuar konfidencialitetin, lirinë individuale, duke mos anashkaluar edhe qëllimet e hulumtimit.

Duke marrë parasysh se parimi i hulumtimit ka pasur të bëjë me cilësi, edhe qasja me pjesmarrësit gjatë hulumtimit është e barabartë në respektimin maksimalisht të të drejtës së tyre dhe se

informacionet që mblidhen nga ata do të përdoren vetëm për qëllime studimore dhe anonimiteti i tyre do të jetë i garantuar.

IV REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë pjesë të kapitullit do të prezentohen rezultatet e hulumtimit të realizuara.

Si fillim do të prezantohen informacionet e përgjithshme të pjesëmarrësve në hulumtim me rezultatet e intervistës dhe listës së kontrollit.

IV.1 Intervista e realizuar me mësueset

Numri i pjesëmarrësve në hulumtim përmes intervistës janë N=4 mësuese që punojnë në institucione të shkollës fillore publike.

n=2 mësuese në komunën e Ferizajt dhe n=2 mësuese në komunën e Gjilanit.

Intervista është realizuar me mësueset e ciklit fillor, duke marrë pëlqimin e tyre dhe se përgjigjet e dhëna do të përdoren vetëm për qëllimin e studimit dhe anonimiteti i tyre do të jetë i garantuar.

Të dhënat e mbledhura, në këtë hulumtim cilësor, me anë të intervistës gjysmë të strukturuar, janë analizuar duke u krahasuar edhe me literaturën e shqyrtuar, u koduan dhe u transkriptuan të plota. Këto bëhen vetëm në kohën kur i dëgjuam disa herë inçizimet e bëra, dhe më pëlqimin e pjesëmarrësve u shkruan dhe rilexuan me kujdes të veçantë.

Tabela 2 Të dhënat e pjesëmarrësve të intervistës.

Numri	Gjinia	Mosha	Përvoja e punës	Kodimi
1.	F	59	Mbi 16 vjet	M 1
2.	F	34	11 vjet	M 2
3.	F	32	7 vjet	M 3
4.	F	46	9 vjet	M 4

Në pyetjen e parë **“Si i vlerësoni nxënësit?”** nga intervista e realizuar më mësuese e dy komunave ishte në mënyrë të vazhdueshme, duke marrë parasysh edhe ditarin personal, që përbëjnë përqindjet për secilën fushë kurrikulare, nxënësit për secilën fushë kanë rubrikat që do të vlerësohen, si shëmbull M 1 ka deklaruar mënyrën e vlerësimit të saj në një fushë kurrikulare si gjuhë dhe komunikimi, *“vlerësimi bëhet për lexim dhe komentim, aktivitete, teste dhe detyra kontrolluese, detyrat e shtëpisë si dhe portofolio lëndor.”*

M 2 ka thënë se *“Nxënësit përveç vlerësimit të vazhduar, vlerësimi është motivues dhe duke përdorur sa më shumë instrumente që ndihmojnë nxënësit të shprehin veten e tyre, përdorin instrumente të ndryshme për të ndihmuar nxënësin që të shpreh veten, pasi që secili nxënës ka stilin e ndryshëm të të nxënës, ashtu duhet përshtatur edhe instrumentin e tyre të vlerësimit.”*

M 3 ka thënë se *“vlerësimi kryhet nëpërmjet vlerësimit të vazhduar vlerësimi për të nxënë që përfshin 40% të notës, vlerësimit me test/detyrë përmblendhëse 40% dhe vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit që përfshin 20%.”*

Edhe M 4 është deklaruar që *nxënësit vlerësohen ‘në mënyrë të vazhdueshme, dhe se bëhet në mënyrë progresive duke vëzhguar procesin e tyre të të mësuarit. Kriterët e vlerësimit janë aktiviteti në klasë, detyrat e shtëpisë, testet dhe ushtrimet kontrolluese si dhe portofolio i nxënësit.”*

Element i përbashkët i tyre është se të gjitha mësuesit përdorin përqindjet për të vlerësuar, pra përdornin vlerësim të vazhdueshëm.

Në pyetjen e dytë **“A e përdorni portofolion si pjesë të vlerësimit tuaj dhe sa herë gjatë vitit e përdorni?”**

Të gjitha mësuesit janë deklaruar se përdorin edhe portofolion si pjesë të vlerësimit të tyre, përgjigjet e tyre i kam marrë pothuajse të njejtat, të cilat deklarojnë se gjatë gjithë vitit shkollor e përdorin portofolion dhe pothuajse çdo ditë nxënësit koleksionojnë punimet që realizojnë në orë mësimore.

Shëmbull M2 është shprehur se *“ portofolio përdoret çdo ditë në klasë, për çdo lëndë, secilin punim që nxënësit e realizojnë në klasë e vendosin në portofolio”*

Në pyetjen e tretë **“A e aplikoni vlerësimin e fëmijëve përmes portofolios në të gjitha fushat apo vetëm në një fushë të caktuar. Nëse vetëm në një fushë, në cilën fushë e aplikoni ju më shumë?”** me intervistë me mësuesit, shumica prej tyre është deklaruar se vlerësimin e nxënësve përmes portofolios e përdorin në të gjitha fushat kurrikulare, ndërsa njëra nga mësuesit si M1 theksonte se nuk e aplikon në të gjitha fushat pra ka deklaruar se *..” përdoren vetëm në fushën e artit se aty ka punime të nxënësve, ka vizatime të ndryshme ndërsa për fushat e tjera nxënësit vlerësohen përmes performancës”*, ndryshe mësuesit e tjera M3 dhe M4 që

deklarojnë se “*portofolio si pjesë e vlerësimit të vazhduar përdoret në të gjitha fushat kurrikulare, duke koleksionuar punime të nxënësve të realizuar gjatë orës mësimore.*”

Në pyetjen e katërt “**Çfarë qëllimi mendoni se ka vlerësimi përmes portofolios profesionale?**” nga intervista me mësimdhënëse marrim përgjigje kryesisht se qëllimi i vlerësimit është që të vërehet zhvillimi përgjithshëm i nxënësve duke shprehur të arriturat si dhe ngecjet e fëmijëve si shembull M1 është deklaruar se ..” *qëllimi kryesor është të shoh të arriturat, ngecjet, zhvillimi i përgjithshëm, përparimet, pasi çdo fëmijë është unik në mënyrën e tij dhe secili ka botën e tyre të shprehurit*”, ndryshe nga M4 ka shprehur se ..” *qëllimi im është që të shoh zhvillimin tërësor, potencialin e nxënësit dhe aftësitë e tij të shprehurit*” .

Mësimdhënësja tjetër, M2 është deklaruar se “*portofolion e përdor për qëllime vlerësimi, por në të njëjtën kohë edhe për të ndihmuar në të shprehurit e kreativitetit të nxënësit*”.

M3 është shprehur se “*portofolion e përdor për të lejuar që nxënësi të merr pjesë në procesin e vlerësimit, pra nxënësit i lejohet që të merr pjesë në mënyrë aktive duke koleksionuar punimet e tij përgjatë vitit shkollor mësimorë, nxënësit i ndihmon që të ndërton edhe aftësitë e tij njohëse, shprehëse, sociale, vepruese e ndërvepruese përmes punimeve të tij*”.

Në pyetjen e pestë”**Përmes aplikimit të portfolios në vlerësim, çfarë ndikimi ka në performancë të nxënësve?**”

Shumica e mësueseve kanë deklaruar se portofolio ndikon në mënyrë pozitive në performancë të nxënësve.

M 1 është deklaruar se “*Ndikimi i portfolios është pozitiv, nxënësi aktivisht ndërton të nxënësit e tij, si shembull në gjuhë dhe komunikimi zhvillohet përformanca kur koleksionohet punimet që ka të bëjë me njësinë mësimore, pra një tregim plotësohet kur ndërtohet korniza e tregimit që realizohet nga një fletëpunuese dhe kështu ndikon direkt në performancë pasi që kur bëhet vlerësimi i tij nxënësi ka pasqyrë nga fletëpunuese që ka koleksionuar në portofolio.*”

M 2 ka deklaruar se “*Mendoj që përformanca pozitive e nxënësve do të zhvillohet atëherë kur nxënësit i lejohet të zhvilloj kreativitetin, shkathtësinë e tij dhe mënyrën e ndryshme të shprehurit dhe e gjithë kjo realizohet në rastin kur atyre ju kërkojmë të koleksionojnë punime, duke ndërtuar kështu edhe të nxënësit aktiv të tyre*”

M 3 ka deklaruar se “*Po, ndikimi saj mund të jetë pozitiv në zhvillimin e të kuptuarit dhe shkathtësive të tjera duke udhëzuar nxënësit të përdor pozitivisht portofolion, jo vetëm për qëllime të mbledhjes së punimeve, por të kërkojmë që të reflektoj mbi çdo punim që do të realizoj*”

M 4 është deklaruar se “*vlerësimi përmes portofolios profesionale si një model vlerësimi më përmirëson aktivitetet mësimore, ndaj ndikimi është pozitiv, ndikon në performancë në përmirësimin e nivelit të të kuptuarit dhe gjithashtu motivon nxënësit që të gjejnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre në të nxënësit.*”

Në pyetjen e gjashtë “Çfarë elemente kontrolloni dhe vlerësoni në portofolion e nxënësve?” me intervistë me mësuese, shumica kanë pasur një formë përgjigjesh duke theksuar se portofoliot e nxënësve kontrollohen në fund të vitit shkollor dhe përfshijnë punime të përfunduara që nxënësit i bëjnë në klasë dhe nuk përfshijnë fletëvlerësime të tjera.

M 1 është deklaruar “ në portofolion e nxënësit përfshihen punime të përfunduara të nxënësve, punimet e papërfunduara të tyre i marrin në shtëpi për t’i përfunduar, pra përfshihet në procesin e vlerësimit vetëm punime që nxënësi i bën në klasë, punimet e fëmijëve nuk krahasohen me njëri-tjetrin kur t’i realizojnë në klasë, pra nuk përmbajnë edhe fletëvlerësime të tjera”.

M 2 është deklaruar se “Elementet që nxënësit do t’i koleksionojnë njoftohen në fillim të vitit shkollor, përmbajnë punime të ndryshme të nxënësve si fleta punuese, vizatime, teste, diktime, shkrime të ndryshme. Unë nuk i krahasoj punimet e nxënësve me fëmijët e tjerë, por kontrollohen në mënyrë individuale, punimet që koleksionojnë janë ato që i realizojnë në klasë”.

M 3 ka deklaruar “Portofolion e nxënësve e kontrolloj dy herë në vit dhe koleksionohen punime të realizuar nga nxënësit në klasë, si vizatime, edhe nese janë me shkarravina lejohen t’i vendosin në portofolion e vlerësimit.”

M 4 ka deklaruar se “Portofolio i nxënësve përmban elemente që i realizon në klasë dhe në shtëpi, si: vizatime, diktime, teste, detyra kontrolluese, detyra të shtëpise dhe të klasës, poashtu edhe punime që nxënësit i realizojnë sipas dëshirës në shtëpi duke shprehur kreativitetin që ata e kanë.

IV.2 Përmbledhje e intervistës së realizuar me mësime dhënëse

Nga intervistat e realizuara, portofoliot profesionale përdoren në shkallën e parë të ciklit fillor dhe janë shprehur se ndikojnë pozitivisht në performancë të nxënësve.

Mësueset janë deklaruar se vlerësimi i nxënësve të shkallës së parë bëhet me fjali për të dy gjysmëvjetorët. Nota përfundimtare jepet në bazë të përqindjeve të nxjerrura nga instrumentet e vlerësimit si listës së kontrollit që përmban teste, detyra kontrolluese, lexim dhe komentim, detyrat e shtëpise si dhe portofolio i të nxënësve.

Qëllimi i vlerësimit të nxënësve përmes portofolios janë shprehur se bëhet për të vlerësuar për të arriturat apo ngecjet e tyre, nxënësit marrin pjesë aktive në procesin e vlerësimit dhe në këtë mënyrë mund të ndikoj edhe në performancë të tyre.

Ajo që përndjeket nga mësueset për përdorimin e portofolio është si mjet vlerësimi, që grumbullohen dhe ruhen materialet e realizuara përgjatë orëve mësimore, poashtu portofolio si mjet vlerësimi shërben në mënyrë pozitive për zhvillim të performancës pasi mësueset u shprehën se nxënësit kreativiteti, ndërtohet aktivisht të nxënësve e nxënësit, përmirësohen aktivitetet mësimore si dhe ndikon në përmirësimin e nivelit të të kuptuarit dhe gjithashtu motivohen nxënësit që të gjëjnë njohuritë dhe kështu të ndërtojnë të nxënësve.

Duket nga përgjigjet e mësueseve se përtofoliot kontrollohen në fund të vitit shkollor, punimet e tyre koleksionohet në klasë, në portofolio nuk përfshihen fletëvlerësime të tjera, poashtu shumica prej tyre deklaruan se portofoliot përfshijnë punime nga të gjitha fushat kurrikulare.

IV.3 Lista e kontrollit për shqyrtimin e portofoliove

Gjatë mbledhjes së të dhënave për listën e kontrollit, i kam shqyrtuar 6 portofolio të nxënësve të zgjedhura në mënyrë rastësore.

Nga klasët e vëzhgimit, të gjithë nxënësit kanë portofolio dhe kanë një vend të caktuar në klasë, në dollapin që mund të qasen dhe janë lehtë të përdorshme.

Tabela 3. Portofolio për nxënësit e klasës parafillore (2 portofolio)

Nga portofoliot e shqyrtuara, në pjesën e të dhënave personale, nxënësit përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin dhe një kopertinë me simbole të ndryshme të zgjedhur nga fëmijët.

Brenda në portofolio, përmbajnë punime të përfunduara të fëmijëve, mbi të cilat në secilin përmbahen edhe data dhe përshkrime, poashtu kishte detyra shtëpie, detyrë klase, përmbajnë edhe vizatime të lira të nxënësve.

Portofolio e nxënësve nuk përmbante punime të papërfunduara, fotografi gjatë aktiviteteve, vëzhgime të fëmijës, fotografi gjatë aktiviteteve.

Tabela 4. Portofolio e klasës së parë (2 portofolio)

Portofolio i nxënësve të kësaj grupmoshe kishte një qëllim të caktuar, të dhënat personale të fëmijëve ishin emri, mbiemri, kopertina kishte një simbol, përmbanin fotografi gjatë aktiviteteve të nxënësit.

Në brendësinë e portofolios kishte punime të përfunduara të tyre, që kishin të lartshënuar datën e realizimit. Portofoliot poashtu përmbanin teste, dikttime, detyra kontrolluese, ushtrime, kishte edhe punime individuale të fëmijëve sidomos vizatime të ndryshme.

Në portofoliot e tyre nuk kishte regjistrime, poashtu nuk përmbante vëzhgime të fëmijëve dhe fletëvlerësim për shokun\shoqen. Portofoliot koleksionin punime nga të gjitha fushat lëndore të nxënësve.

Tabela 5. Portofolio e klasës së dytë (2 portofolio)

Portofolio profesionale e nxënësve kishte një qëllim të caktuar, përmbante të dhënat personale si emrin, mbiemrin, klasën dhe fotografinë e tyre.

Në këto portofolio ishin të vendosura fotografitë gjatë aktiviteteve, punimet ishin të përfunduara. Punimet ishin të ndarë në fusha kurrikulare si gjuhë dhe komunikimi, aty kishte punime të lira duke mundësuar shprehja e kreativitetit të tyre, kishte teste, diktime, detyra kontrolluese, detyra klase dhe të shtëpisë.

Në pjesën tjetër nuk përmbanin vëzhgime të fëmijëve, apo fletëvlerësime për shokun/shoqen.

Tabela 6. Çfarë përmban dhe çfarë nuk përmban portofolio i nxënësve nga shqyrtimi i bërë.

Çfarë përmban	Çfarë nuk përmban
<ul style="list-style-type: none"> ● Emrin ● Mbiemrin ● Fotografi ● Vizatime ● Punime të përfunduara dhe të shënuar me datë ● Diktime, teste dhe detyra kontrolli ● Detyra të shtëpisë dhe klasës 	<ul style="list-style-type: none"> ● Të dhëna të tjera personale të nxënësit ● Fotografi dhe regjistrime ● Vëzhgime të nxënësve ● Fletëvlerësimi që nxënësit të shprehnin mendimi për punimet individuale, për shokun\shoqen, për punë e përbashkëta në grup.

V. DISKUTIMET

V.1 Argumentimit i gjetjeve të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të hulumtimit

Të dhënat e mbledhura nga intervista treguan se mësimdhënëset përdorin portofolion si instrument vlerësimi të nxënësve.

Pyetja kërkimore: Si ndikon portofolio në zhvillimin e performancës së nxënësve të shkallës së parë të ciklit fillor?

Nga aplikimi i portofolios profesionale ndikimi që ka në performancë të nxënësve, mësueset u shprehën se ndikimi i portofolios është pozitiv, ndihmon në zhvillimin e të kuptuarit dhe shkathtësive të tjera, gjithashtu motivojnë nxënësit që t'i gjejnë njohuritë dhe të reflektoj mbi çdo punim që do realizoj, me studimin e bërë (Richard Daniel Herdi Pangkey, 2019) vlerësimi i

portofolit si një model vlerësimi mund të përmirësojë aktivitetet mësimore, ndaj pritet të përmirësojë nivelin e të kuptuarit dhe rezultatet e të nxënësve dhe mund të përmirësojë performancën e nxënësve në shkollat fillore.

Gjithashtu pritet të motivojë nxënësit që të gjejnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre në të nxënësve. Një vlerësim i bazuar në klasë që mund të ofrojë një pasqyrë të përparimit të nxënësve me kalimin e kohës gjatë procesit mësimor është vlerësimi i portofolit.

Nga deklaratimet e mësuesve qëllimi i vlerësimit të portofolios së fëmijës është që shohim zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve, të arriturat dhe ngecjet e nxënësve, ndërsa studimi i bërë nga (Wortham, Barbour, & Perrotta, 1998) është që të sigurojmë të dhënat për qëllimet, interesat, dispozitat kryesore të nxënësve, vlerëson të arriturat e nxënësve në lidhje me standardet individuale, i mundëson fëmijëve të vetëreflektojnë dhe analizojnë proceset e të nxënësve të tyre.

Mësueset deklaruan që portofolion e përdorin për të grumbulluar materialet nga të gjitha fushat kurrikulare, kjo vjen në përputhje edhe me studimin e (Grace, 1993) i cili theksoi se portofolio i nxënësve duhet të përfshijë në të gjitha fushat pasi që përfshijnë: zhvillimin motorik të fëmijës, aftësi gjuhësore, njohuri matematikore, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimin artistik, qasjet drejt të mësuarit dhe zhvillimin e përgjithshëm njohës.

Rezultatet e hulumtimit vërtetojnë hipotezën e parë që portofolio profesionale ndikon në mënyrë pozitive në zhvillimin e performancës së nxënësve të shkollës së parë të ciklit fillor, pasi që ndikon në mënyrë pozitive në zhvillimin e të kuptuarit, menduarit kritik që mundëson që nxënësi të reflektoj mbi punimet e tij.

Pyetja kërkimore: Sa shpesh përdoret portofolio në vlerësimin e nxënësve në shkollën e parë të ciklit fillor?

Në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të portofolios profesionale në shkollën e parë, nga intervista dhe lista e kontrollit shohim se përdoren portofolion në vlerësimin e nxënësve duke ruajtur dhe grumbulluar punimet e nxënësve, duke parë progresin e nxënësve, përdoren çdo ditë në orë mësimore, që është edhe në përputhje me studimin e bërë nga (Grace, 1993) që theksoi se vlerësimi përmes portofolios është metodë konkrete për të vlerësuar pikat e forta të nxënësve, duke grumbulluar materialet në një dokument.

Rezultatet e hulumtimit e vërtetojnë pjesërisht edhe hipotezën e dytë që portofolio profesionale përdoren shumë shpesh në koleksionimin e punimeve të nxënësve të ciklit fillor të shkollës së parë.

Pyetja kërkimore: Cilat janë elementet e një portofolio profesionale të shkollës së parë të ciklit fillor?

Elementet që përmbajnë portofolio mësueset u deklaruan se koleksionohen materialet që realizohen në klasë mësimore, përfshihen punime të përfunduar të nxënësve si, vizatime, teste dhe detyra kontrolluese, poashtu edhe detyra apo vizatime të tjera që nxënësit i realizojnë që mundësojnë

zhvillimin e kreativitetit, si dhe nga shqyrtimet e portofoliove përmbanin të dhënat personale si emrin, mbiemrin, vizatime, punime të përfunduara dhe të shënuar me datë diktimit, teste dhe detyra kontrolli, detyra të shtëpisë dhe klasës. Sipas shqyrtimit të bërë nga Grace (1993) autorë të ndryshëm kanë dhënë mendime lidhur se çfarë mund të përfshijë një portofolio. Sipas tij portofoli mund të përfshijë kampione pune, regjistrime të formave të ndryshme të vëzhgimeve sistematike, dhe teste shqyrtimi. Ndërsa (Shaaban, 2007, p. 3) portofolio duhet të përmbajë punimet e nxënësve, si: vizatimet, mostra të ngjyrosjes etj., video – është mënyra më e mirë që ta kapim punën e nxënësve, ku mundemi t'i dokumentojmë shkathhtësitë gjuhësore, fizike, etj., fotografi – ku nxënësi është duke punuar në mënyrë individuale apo grupore.

Sipas shqyrtimit të portofoliove të nxënësve punimet pjesërisht kishin data, ndërsa (Wortham, Barbour, & Perrotta, 1998) theksoi se gjatë mbledhjes së punimeve të nxënësve duhet shënuar data kur është bërë ai punim, në mënyrë që portofolio të lejojë që të shihet ndryshimi dhe përparimi i nxënësit gjatë një periudhe mësimore.

Rezultatet e hulumtimit hedhin poshtë hipotezën e tretë që portofolio në ciklin fillor të shkollës së parë përfshinë punimet e nxënësve vetëm nga fusha e artit, kjo pasi që nga shumica e mësuesve kemi marrë përgjigje se portofoliot koleksionojnë punime nga të gjitha fushat kurrikulare.

VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë pjesë do të paraqiten përfundimet dhe rekomandimet nga hipotezat e ngritura në hulumtim. Në bazë të hulumtimit nga metodologjitë e ndryshme, rezultateve të studimit dhe nga interpretimi i tyre kemi ardhur në disa përfundime dhe janë dhënë rekomandime për mësuese.

VI.1 Përfundimet

Ky hulumtim kishte për qëllim kryesor të shoh zhvillimin e performancës së nxënësve nga punimet e portofolieve, përkitazi se si ndikonte ky mjet vlerësimi në performancë të nxënësve. Nga studimi i bërë vjen përfundimi për një ndikim pozitiv dhe është i rëndësishëm të aplikohet portofolio si pjesë në procesin e vlerësimit.

Punimet që përcaktohen për realizimin e portofolieve, ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillim të performancës së nxënësit, prandaj përveç se është e rëndësishme të përdoret portofolio profesionale si mjet vlerësues, njëkohësisht duhet të përcaktohen qartë dhe saktë elementet që duhet të përfshihen në mënyrë që të shohim saktë edhe të arriturat apo ngecjet e fëmijëve.

Është shumë e rëndësishme që të vlerësohen nxënësit përmes portofolios, pasi mundëson të shohim progresin në vazhdimësi, përmes portofolios profesionale shohim ecurinë e nxënësve në të nxënit e tyre, kjo ndikon në performancë pasi që nxënësit shohin gabimin e tyre dhe kushtohet vëmendje për korrigjimin e tyre.

Portofolio profesionale ndihmon dhe aftëson nxënësin të zhvillojë të mësuarit, pasi si proces është i lidhur drejtpërdrejtë me procesin e të nxënit. Sipas studimit të bërë ndihmon në zhvillimin e nivelit të të kuptuarit, duke i motivuar nxënësit për të nxënë në mënyrë të pavarur dhe aktive.

VI.2 Rekomandimet

Nga studimi i bërë, vihet në një përfundim për përdorim të portofolios për një performancë pozitive të nxënësve, kjo mund të bëhet vetëm nëse kemi përkushtim nga të gjithë si nxënësit njëkohësisht edhe mësuesit, në mënyrë që përdorimi i portofolio të përdoret në mënyrë efektive, të njihet në procesin e vlerësimit të nxënësve dhe gjithashtu të përdoret si mjet vlerësimi.

Disa nga rekomandimet që mund t'i bëjmë për mësuesit nga hulumtimi janë:

- Mësueset të ndjekin trajnime që kanë të bëjnë me vlerësimin e nxënësve përmes portofolios, që ndikon në zhvillim profesional.
- Rekomandohet që mësuesit të përcaktojnë vlerësimin duke përfshirë si pjesë të saj portofolion profesionale.
- Mësuesit të përdorin portofolion profesionale në mënyrë që të ndikojnë në motivimin, ndërveprimin dhe që të ndihmojnë nxënësit për të nxënë në mënyrë kritike.

- Të bashkëpunohet me aktivin profesional gjatë procesit të planifikimit të vlerësimit
- Mësueset gjatë procesit të vlerësimit përmes portofolios të ndërmarrë ndryshimet si:
Përmes përdorimit të portofolios nxënësit t'i ndihmoj në të nxënit e tyre
T'i shikoj dhe diskutoj punimet e tyre para tyre
Të përfshihen regjistrime dhe fotografi në portofolio për aktivitetet e tyre
Të përfshihen fletëvlerësimi, vlerësime për veten e tyre apo edhe shokut\shoqes së tij\ saj.

LITERATURA

- Ahmedi, V. (2019). *VLERËSIMI FORMATIV NË ARSIMIN FILLOR NË KOSOVË DHE*. Prishtine: Zero Print.
- Andoni, M. (2016). *UDHËZUES PËR HARTIMIN E MATERIALEVE* . Prishtine: ALLED.
- Baki, A., & Birgin, O. (2004). Reflections of Using Computer-Based Portfolios as an Alternative Assessment. *The Turkish Online Journal of Educational Technology*.
- Baki, A., Birgin, O., Guven, B., & Karataş, İ. (2004). BİLGİSAYAR DESTEKLİ BİREYSEL GELİŞİM DOSYASI (PORTFOLİO). *Eğitimde İyi Örnekler Konferansı*.
- Birgin, O. (2003). Investigation of the Application Level of a Computer Based Portfolios. *Unpublished Master's Thesis*.
- Birgin, O. (2006). İlköğretimde Portfolyo Değerlendirme Yönteminin Uygulanması Sürecinde Karşılaşılan Sorunlar ve Çözüm Önerileri. *Ulusal Matematik Eğitimi Öğrenci Sempozyumu*.
- Brown, G., Bull, J., & Pendlebury, M. (1997). *Assessing Student Learning in Higher Education*. London: Routledge.
- Chen, G.-D., Liu, C.-C., Ou, K.-L., & Lin, M.-S. (2000). Web Learning Portfolios: A Tool For Supporting Performance Awareness. *Innovations in Education and Teaching International*, 38(1), 19-30.
- Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997). *Krijimi i klasave me fëmijët në qendër : Fëmijët 3-5 vjeçarë*. Uashington: Biblioteka e Kongresit.
- De Fina, A. A. (1992). *Portfolio Assessment: Getting Started*. (reissue, Re.) New York: Scholastic Professional Books.
- Grace, C. (1993). *The portfolio and its use: Developmentally appropriate Assessment of young children* (Vëll. i II). (L. E. Gronlund, Re.) Washington, USA, USA: ERIC.
- Gronlund, L. E. (1993). *Striving for Excellence: The National Education Goals* (Vëll. i 3). Washington, USA, USA: Educational Resources Information Center.
- IZHA. (2016, 12). *Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor*. Gjetur në Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor: <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/03/Korniza-Kurrikulare-e-arsimit-parashkollorit-IZHA-Dhjetor-2016.pdf>
- MASHT. (2006). *Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë*. Prishtinë, Kosovë, Kosovë: LIBRI SHKOLLOR. Gjetur 04 10, 2020, nga <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-parashkollore.pdf>

- MASHT. (2010, 11). *Standardet e vlerësimit*. Gjetur në Standardet e vlerësimit: https://drejtoare.weebly.com/uploads/1/1/4/6/11467098/standardet_e_vleresimit_drafti_final.pdf
- MASHT. (2010). *Vlerësimi i brendshëm*. Departamenti i Arsimit, Prishtinë. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/vleresimi-i-brendshem.pdf>
- MASHT. (2013). Gjetur në Korniza Kurikulare e Kosoves: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/prezantim-kkk-vleresimi-dhe-zbatimi-23-shkurt-2013.pdf>
- MASHT. (2016, 07). *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar)*. Prishtinë, Kosovë, Kosovë: "BLENDI". Gjetur në Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar): <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- MASHT. (2016). *Udhëzim administrativ nr.08/2016 për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Gjetur 04 11, 2020, nga https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve_1.pdf
- MASHT. (2018). <https://konsultimet.rks-gov.net>. Gjetur në Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/13-50-56-27042018/Draft%20Kurrikula%20b%C3%ABrtham%C3%AB%20p%C3%ABr%20edukim%20n%C3%AB%20f%C3%ABmij%C3%ABrin%C3%AB%20e%20hershme%200-5%20vje%C3%A7.pdf>
- MASHT. (2018). *Kurrikula bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç*. Prishtinë, Kosovë, Kosovë.
- MASHT. (2019). *Statistikat e arsimit në Kosovë*. Prishtinë: CIP.
- MASHT. (2020, 04). <https://masht.rks-gov.net>. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net>: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>
- Mato, E., & Kamani, P. (2000). *Në kërkim të njohjes*. Tiranë: Shtypshkronja "Marin Barleti".
- MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË. (2019, 10). *Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor*. Gjetur në MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË: <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/11/Korniza-e-vler%C3%ABsimit-n%C3%AB-arsimin-parashkollor-1.pdf>
- Musai, B. (2014). *Metodologji e mësimdhënies*. Tirane: CDE.
- O.Birgin, A.Baki. (2007). The Use of Portfolio to Assess Student's Performance. *Journal of TURKISH SCIENCE EDUCATION* .
- O.Biring, A.Baki. (2007, 09). The Use of Portfolio to Assess Student's Performance. *TURKISH SCIENCE EDUCATION*, 4(2).
- Osman BİRGİN, A. B. (2007). Përdorimi i portofolit për të vlerësuar performancën e studentit. *TURKISH SCIENCE EDUCATION*, 82-83.
- Plakolli, Z., & Gashi, M. A. (2016). *BASHKËPUNIMI EDUKATORE - PRIND NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE TË KOSOVËS*. Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- Portofolio i te nxenit. (2016, Shtator). *Instituti i zhvillimit të arsimit*, 28. Gjetur në Portofolio i të nxenit.
- Qendra për Demokraci dhe Pajtim në Europën Juglindore. (2013). *Mësimdhënia e të mësuarit e të mësuarit*.
- Richard Daniel Herdi Pangkey, Z. S. (2019, Janar). *The Effect of Portfolio Assessments on Student Learning Outcomes in Learning for Civic Education in Primary School*. Gjetur në Researchgate: https://www.researchgate.net/publication/331494850_The_Effect_of_Portfolio_Assessments_on_Student_Learning_Outcomes_in_Learning_for_Civic_Education_in_Primary_School
- Shaaban, K. (2007, 08 25). Assessment of Young Learners. *English Teaching Forum Online – Bureau of Educational and Cultural Affairs*, 39, 3.
- Shehu, F., Pallçevska, S., Niçova, A., Zindl, V., Mladenovik, B., Ançevska, B., & Janeva, N. (2014). *Zbatimi i standarteve për mësim dhe zhvillim të hershëm*. Shkup: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Gjetur në https://www.unicef.org/northmacedonia/media/34111/file/MK_ApplyingEarlyLearningStandards_Report_AL.pdf
- The Future of Education: Empowering Students with Portfolios. (2023). *wakelet*.
- Thomas, C., Britt, P., Blackburn, J. M., Dean, R. B., Papason, B., Tyler, J. L., & Williams, F. K. (2005). Portfolio Assessment: A Guide For Teachers And Administrators. *NATIONAL FORUM OF EDUCATIONAL ADMINISTRATION AND SUPERVISION JOURNAL*, 23(4), 1-8.
- University of Hawaii*. (2023). Gjetur në Using Portfolios in Program Assessment: <https://manoa.hawaii.edu/assessment/resources/using-portfolios-in-program-assessment/#one>

Warash, B. G., & Workman, M. (2016, 01 06). Teaching Preschoolers to Self-Assess Their Choices in Pre-K. *Journal of Educational Research and Practice*, 6(1), 97-104. doi:DOI:10.5590

Wortham, S. C., Barbour, A., & Perrotta, B. D. (1998). *Portfolio Assessment: A handbook for preschool and elementary educators*. Georgia Avenue: Association for Childhood Education International.

SHTOJCAT

Shtojca 1. Listë kontrolli për shqyrtimin e portfoliëve

DATA: _____

Klasa: _____

HULUMTUESI: _____

Portfolio për grupin:	Po	Jo	Koment
Të gjithë fëmijët në klasë kanë portfolio			
Portfoliot kanë një vend të caktuar në klasë			
Portfoliot janë lehtë të përdorshme nga fëmijët			
Listë kontrolli- Portfolio 1	Po	Jo	Koment
Portofolio përmban të dhënat personale të fëmijës			
Përmban në kopertinë një foto ose simbol të fëmijës			
Janë të vendosura fotografitë gjatë aktiviteteve			
Përmbajnë vetëm punime të përfunduara			
Punimet e fëmijës kanë punime tematike të shënuara me data			
Përmbajnë detyra shtëpie dhe klase			
Portfolio përmban punime individuale që fëmijët i bëjnë në kohën e lirë			
Përmban fotografi dhe regjistrime			

Përmban vëzhgime të fëmijës			
Portfolio përmban diktime, teste dhe detyra kontrolli			
Prapa vizatimeve të fëmijës ka përshkrime			
Fletë vlerësimi ku nxënësit shprehin mendime për punimet individuale, për shokun\shoqen, për punët e përbashkëta në grup			

Shtojca 2. Pyetjet për intervistën me mësueset

Komuna: _____

Institucioni arsimor: _____ **DATA:** _____

1. Si i vlerësoni nxënësit?
2. A e përdorni portofolion si pjesë të vlerësimit tuaj dhe sa herë gjatë vitit e përdorni?
3. A e aplikoni vlerësimin e fëmijëve përmes portfolios në të gjitha fushat apo vetëm në një fushë të caktuar. Nëse vetëm në një fushë, në cilën fushë e aplikoni ju më shumë?
4. Cfarë qëllimi mendoni se ka vlerësimi përmes portfolios profesionale?
5. Përmes aplikimit të portfolios në vlerësim, cfarë ndikimi ka në performancë të nxënësve?
6. Cfarë elemente kontrolloni dhe vlerësoni në portofolion e nxënësve?